

VENDIM
Nr. 29, datë 26.5.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Fiona Papajorgji,	anëtare;
Elsa Toska,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Illir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahim,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 26.5.2023, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 3 (I) 2022 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Trojan Pavlovski

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Departamenti i Administratës Publike

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-1029 (210), datë 26.5.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtuës me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, pika 1, 11, pika 3, 15, 17, pika 1, 18, pikat 1 dhe 2, 35, pika 3, 41, pika 1, 42, 43, 59, 116, 142, pika 1 dhe 146, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1, 27, 39, 42, 71, 71/a dhe 76, pika 6, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (*MBZHR*) dhe Departamentit të Administratës Publike (*DAP*), që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuari Trojan Pavlovski, në datën 11.1.2013, ka nënshkruar kontratën për fillimin e marrëdhënieve të përkohshme të punës në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (*sot Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural*), në pozicionin e përgjegjësit në sektorin e marketingut dhe tregjeve bujqësore. Në vijim, me shkresën e datës 31.1.2013, të sekretarit të përgjithshëm të MBZHR-së, ai është emëruar përkohësisht në këtë detyrë, deri në përfundimin e procedurave të konkurrimit, sipas ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, të ndryshuar (*ligji nr. 8549/1999*). Në datën 16.4.2013, DAP-i e ka emëruar atë nëpunës civil në periudhë prove.

2. Në datën 30.5.2013, Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” (*ligji nr. 152/2013*), i cili parashikonte datën 1 tetor 2013, si momentin e hyrjes në fuqi (*neni 72*). Hyrja në

fuqi e këtij ligji sillte si pasojë shfuqizimin e ligjit nr. 8549/1999, dhe të çdo dispozite tjetër në kundërshtim me të (*neni 70*). Gjatë kohës që pritej hyrja në fuqi e ligjit, Këshilli i Ministrave ka miratuar aktin normativ nr. 5, datë 30.9.2013, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”” (*akti normativ nr. 5/2013*), me qëllim shtyrjen në kohë të efekteve të ligjit nr. 152/2013. Akti normativ ka hyrë në fuqi menjëherë dhe është miratuar nga Kuvendi me ligjin nr. 161/2013, datë 17.10.2013. Këto dy akte janë shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*) me vendimin nr. 5, datë 5.2.2014 (*vendimi nr. 5/2014*), i cili ka hyrë në fuqi në ditën e botimit në Fletoren Zyrtare nr. 18, datë 26.2.2014.

3. Në datën 30.10.2013, kërkuesi është njoftuar lidhur me propozimin për kalimin në listëpritjeje, për shkak të ristrukturimit të përgjithshëm të organikës së institucionit, në zbatim të ligjit nr. 8549/1999. Me shkresën e datës 6.11.2013, MBZHR-ja i ka propozuar DAP-it kalimin në listëpritjeje të kërkuesit, i cili është miratuar me shkresën e datës 13.11.2013. Në vijim, sekretari i përgjithshëm i MBZHR-së ka njoftuar kërkuesin me shkresën e datës 22.11.2013. Duke mos qenë dakord me këtë vendim, në datën 20.3.2014, ai i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi për pavlefshmërinë absolute të shkresës së datës 22.11.2013 dhe shkresës së datës 13.11.2013, si dhe të pasojave të tyre, kthimin në vendin e punës ose në vendet e shpallura të lira, si dhe konfirmimin e statusit të nëpunësit civil.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 3610, datë 26.6.2014, ka rrëzuar padinë e kërkuesit si të pabazuar në ligj dhe në prova, pasi ka konkluduar se referuar kohës së kryerjes së veprimeve administrative, objekt verifikimi, dhe kuadrit ligjor që ka qenë në fuqi në atë kohë, çështja zgjidhet mbështetur në ligjin nr. 8549/1999 dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Sipas saj, në rastin në gjykim nuk u konstatua asnjë nga rastet e pavlefshmërisë absolute të një akti administrativ, sipas përcaktimeve të neneve 115 dhe 116, të Kodit të Procedurave Administrative (*KPA*).

5. Mbi bazën e ankimit të kërkuesit, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 414, datë 3.3.2016, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë, pranimin pjesërisht të padisë, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve të kundërshtuara, kthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës ose në një vend tjetër ekuivalent me të, si dhe pagesën e pagës nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në ekzekutimin e këtij vendimi. Ajo gjykatë ka vlerësuar se në rastin në shqyrtim gjen zbatim ligji nr. 152/2013, i cili i shtrin efektet nga data 1.10.2013, për sa kohë që për këtë çështje nuk ka ende një vendim të formës së prerë, pasi ajo është në gjykim në këtë gjykatë, si dhe për pasojë të rrëzimit të shkakut që shtynte në kohë efektet ligjore të tij. Ajo ka tërhequr vëmendjen mbi faktin se aktet objekt gjykimi i përkasin kohës pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, pra pas datës 1.10.2013, dhe se e gjithë procedura e ndjekur për kalimin e kërkuesit në listëpritjeje ka nisur dhe ka përfunduar pas hyrjes në fuqi, çka e bën të detyrueshëm zbatimin e këtij ligji. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar rekurs DAP-i dhe MBZHR-ja, si dhe dy kundërrekruse kërkuesi.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, fillimisht, me vendimin nr. 221, datë 14.4.2016, (*vendimi nr. 221/2016*), ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe me vendimin nr. 221/1, datë 6.11.2018, nuk ka pranuar kërkesën e kërkuesit për revokimin e atij vendimi. Ndërsa në datën 13.2.2018, ka vendosur kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore me praninë e palëve ndërgjyqëse.

7. Kërkuesi në datën 28.5.2020, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për revokimin e vendimit nr. 221/2016 dhe të njëjtën kërkesë ai e ka paraqitur sërish në datën 25.6.2021. Po kështu, në datën 31.5.2021, ai i është drejtuar zëvendëskryetarit të Gjykatës së Lartë me kërkesë për gjykimin e çështjes së tij me procedurë të përshpejtuar, ndërsa në datën 1.11.2021, nëpërmjet avokatit të tij, ka paraqitur dy kërkesa të tjera, duke kërkuar revokimin e vendimit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore dhe kthimin e saj për shqyrtim në dhomën e këshillimit, revokimin e vendimit nr.

221/2016, si dhe shqyrtimin e kërkesave brenda një afati të arsyeshëm ligjor. Me kërkesën e datës 20.4.2022, kërkuesi ka kërkuar informacion lidhur me ecurinë dhe statusin e gjykimit të çështjes së tij.

8. Gjykata e Lartë, me vendimin e datës 9.5.2022, ka revokuar vendimin e datës 13.2.2018, dhe ka vendosur shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve në datën 26.5.2022. Më pas, me vendimin nr. 00-2022-1029 (210), datë 26.5.2022, kjo gjykatë, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 414, datë 3.3.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 3610, datë 26.6.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se rekursi përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*), pasi qëndrimi i Gjykatës Administrative të Apelit ishte i gabuar dhe arsyetimi nuk përputhej me parashikimet e ligjeve nr. 8549/1999 dhe nr. 49/2012, si dhe të KPA-së të vitit 1999, që gjejnë zbatim në rastin konkret.

9. Në datën 12.10.2022, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1029 (210), datë 26.5.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën. Kolegji i Gjykatës në datën 11.1.2023, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Fillimisht, seanca plenare për shqyrtimin e çështjes është caktuar në datën 20.4.2023, por për arsye objektive zhvillimi i saj është shtyrë për në datën 26.5.2023, ndryshim për të cilin palët janë njoftuar rregullisht.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

10.1. *Parimit të gjykatës së caktuar me ligj*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka marrë një vendim që ka ndryshuar praktikën gjyqësore dhe një kompetencë e tillë, bazuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile (KPC), i takonte vetëm Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Vendimi është i ndryshëm nga praktika e vendosur më herët nga ky kolegji në vendimin nr. 00-2014-730, datë 6.3.2014, gjë e cila i ka sjellë kërkuetit pasoja të pafavorshme.

10.2. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi gjykata duhet të mbrojë pritshmëritë legjitime që rrjedhin nga zbatimi i normave juridike që janë në fuqi në kohën kur individët ushtrojnë të drejtat e tyre. Vendimi bie në kundërshtim me efektet e vendimit nr. 5/2014, të Gjykatës, në shkelje të nenit 76, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, duke njohur si të vlefshme aktet administrative të nxjerra bazuar në një akt normativ të shpallur si të papajtueshëm me Kushtetutën. Kjo ka sjellë edhe cenimin e *së drejtës për gjykim të drejtë*.

10.3. *Së drejtës së mbrojtjes*, pasi nuk është njoftuar lidhur me vendimin e revokimit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, duke i mohuar mundësinë për t’u njohur me arsyet e këtij vendimi dhe të paraqitjes së parashtrimeve përpara zhvillimit të seancës në dhomën e këshillimit. Po kështu, kjo mundësi atij nuk i është dhënë edhe për faktin se është njoftuar 9 ditë përpara zhvillimit të seancës.

10.4. *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi Gjykatës së Lartë i është dashur më shumë se 6 vjet për të gjykuar përfundimisht çështjen e tij, ekzekutimi i së cilës ishte pezulluar dhe ajo nuk paraqitej komplekse ose e ndërlikuar, madje kategorizohej në çështje që shqyrtohen me procedurë të përsheptuar. Kërkesave të tij, jo vetëm që nuk u janë kthyer përgjigje, por as nuk janë shqyrtuar nga gjykata.

11. **Subjekti i interesuar, MBZHR-ja**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

11.1. Pretendimi për *cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj* është i pabazuar, pasi vendimi i referuar i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë ka si objekt të tij zgjidhjen e çështjes së juridiksionit, nëse ajo i përkiste atij administrativ ose civil dhe nuk është shprehur për zgjidhjen në themel të çështjes. Vendimi i referuar nuk është i detyrueshëm për gjykatat e nivelit më të ulët.

11.2. Pretendimi për *cenimin e parimit të sigurisë* nuk qëndron, pasi është detyrë e ligjvënësit që nëpërmjet akteve të tij të rregullojë me hollësi të drejtat e individëve të parashikuara në Kushtetutë. Në rastin e kërkuarit, akti administrativ për kalimin e tij në listëpritjeje është i ligjshëm, pasi është nxjerrë nga organi kompetent, i cili ka respektuar procedurat e ligjit nr. 8549/1999, që ka qenë në fuqi në atë kohë. Ky ligj parashikonte rastin e largimit nga shërbimi civil për shkak të mbylljes ose ristrukturimit të institucionit dhe zbatimi i tij mbështetet edhe në nenin 68 të ligjit nr. 152/2013. Sipas këtij të fundit, procedurat e nisura, bazuar në ligjin nr. 8549/1999, përfundojnë sipas dispozitave të po këtij ligji. Për rrjedhojë, edhe pretendimi për *cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë* nuk është i bazuar në ligj.

11.3. Lidhur me pretendimin për *cenimin e së drejtës së mbrojtjes* për shkak të mosdhënies së mundësisë për t'u njohur me vendimin për kalimin e çështjes për gjykim në dhomën e këshillimit dhe paraqitjes së parashtrimeve me shkrim përpara zhvillimit të saj, kërkuari nuk ka paraqitur argumente kushtetuese, por vetëm ka sqaruar kronologjinë e situatës. Me shkresën e datës 16.5.2021, kërkuari ka marrë dijeni për datën e zhvillimit të seancës gjyqësore dhe nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim në përgjigje të saj.

11.4. Pretendimi për *cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm* është i pabazuar, pasi vonesa ka ndodhur për shkaqe që qëndrojnë përtej vullnetit të Gjykatës së Lartë, të cilat lidhen me efektet e zbatimit të reformës në drejtësi. Po kështu, pavarësisht se ai ka pretenduar cenimin e kësaj të drejte, nuk ka argumentuar lidhjen me rrethanat dhe faktet e çështjes në aspekt të kompleksitetit të çështjes, objektit të mosmarrëveshjes, të procedimit ose të gjykimit, si dhe sjelljes së organit që po kryen procedurat. Në rastin konkret, kërkuari nuk ka provuar se ka treguar interes për gjykimin sa më të shpejtë të çështjes dhe nuk e ka përdorur mjetin ligjor për të kërkuar përsheptimin bazuar në nenin 460, pika 3, të KPC-së.

12. Subjekti i interesuar, DAP-i, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

12.1. Pretendimi i kërkuarit për *cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj* është haptazi i pabazuar, pasi nuk rezulton të ketë çështje të ngjashme me rastin në shqyrtim, ku trupat e Kolegjit Administrativ të kenë mbajtur qëndrime të ndryshme ose vendimmarrja e tyre nuk ka qenë unanime në lidhje me efektet e vendimit nr. 5/2014, të Gjykatës. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në rastin në shqyrtim, nuk ndodhej në kushtet e nenit 62/a, të ligjit nr. 49/2012, për nisjen e procedurës për të njëzuar ose ndryshuar praktikën gjyqësore. Përfundimi i arritur nga gjykata për ligjin e zbatueshëm përbën çështje të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, gjë e cila nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues.

12.2. Pretendimi për *cenimin e parimit të sigurisë juridike* nuk qëndron, pasi ky parim lidhet me besimin te sistemi juridik për mosndryshimin e një situate të favorshme ligjore dhe nuk lidhet me pushtetin gjyqësor. Në rastin konkret, vendimi nr. 5/2014, i Gjykatës do të kishte efekt prapaveprues, sipas nenit 76, pika 2, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, nëse çështja do të kishte qenë në shqyrtim gjyqësor në datën 26.2.2014, ndërsa kërkuari e ka paraqitur padinë në datën 20.3.2014, pra pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Kërkuari duhet t'i adresonte gjykatës argumente për pavlefshmërinë e aktit administrativ të kalimit në listëpritjeje, referuar ligjit që ka vepruar në atë kohë dhe jo ligjit të mëvonshëm. Përcaktimi i ligjit të zbatueshëm për zgjidhjen e çështjes përfshihet brenda kompetencave të Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit.

12.3. Pretendimi lidhur me mungesën e njoftimeve, në thelb, lidhet me *të drejtën e aksesit, për t'u dëgjuar dhe mbrojtur*, i cili rezulton të jetë i pabazuar. Njoftimi me shpallje është publikuar në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë në datën 10.5.2022, pra 15 ditë përpara datës 26.5.2022, kur është

zhvilluar gjykimi. Kërkuesit i është krijuar mundësia për të paraqitur argumentet e tij me shkrim, pasi ai ka paraqitur kundërrekurs. Ai nuk ka provuar se vendimi i kundërshtuar do të ishte i ndryshëm nëse ai do të kishte marrë dijeni 15 ditë përpara datës së zhvillimit të seancës. Po kështu, nuk rezulton që ai t'i jetë drejtuar me kërkesë Gjykatës së Lartë për shtyrjen e seancës, me qëllim respektimin e afatit të njoftimit.

12.4. Pretendimi për *cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm* nuk qëndron, pasi zgjatja e afatit është pasojë e faktorëve objektivë të njohur, si reforma në drejtësi dhe procesi i *vetingut*. Kërkuesi nuk ka paraqitur kërkesë për përsheptimin e shqyrtimit të rekursit bazuar në ndryshimet e KPC-së të vitit 2017, megjithëse ka pasur kohë të mjaftueshme në dispozicion për t'u njohur dhe për t'i shfrytëzuar ato, duke mos shteruar kështu mjetet juridike efektive në dispozicion.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

13. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraparak të kërkesës.

14. Gjykata çmon se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, në të cilin është vendosur për padinë e tij me objekt marrëdhëniet e punës, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë për çështjen e parashtruar.

15. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime, për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare, që do të thotë se individit duhet t'i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore (*shih vendimet nr. 23, datë 10.10.2022; nr. 14, datë 11.3.2021; nr. 17, datë 16.5.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Në thelb, ky rregull synon t'u japë organeve publike dhe, në veçanti, gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mundësinë të parandalojnë ose korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit. Ana tjetër e rregullit të shterimit të mjeteve juridike efektive përfshin detyrimin e vetë individit që të tregojë kujdesin dhe vëmendjen e duhur për të paraqitur kërkesa, kundërshtime ose ankime te organet publike dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për rrethanat që mbështesin pretendimet për cenimin e të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 10, datë 7.3.2023; nr. 25, datë 13.10.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në çështjen konkrete Gjykata konstaton se kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, për shkak se Gjykatës së Lartë i është dashur më shumë se 6 vjet për të gjykuar përfundimisht çështjen e tij, e cila nuk paraqitej komplekse ose e ndërlikuar. Sipas tij, mosshqyrtimi në kohë i çështjes i ka cenuar edhe të drejtat për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme të zgjedhur vetë, për të zgjedhur profesionin dhe vendin e punës, për barazinë e armëve dhe mosekzekutimin në kohë të vendimeve gjyqësore të formës së prerë etj.

17. Subjektet e interesuara, MBZHR-ja dhe DAP-i, kanë prapësuar se ky pretendim është i pabazuar, pasi vonesa ka ardhur për shkaqe që qëndrojnë përtej vullnetit të Gjykatës së Lartë, të cilat lidhen me efektet e zbatimit të reformës në drejtësi dhe procesit të *vettingut*, dhe se kërkuesi nuk ka paraqitur kërkesë për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes, sipas dispozitave të KPC-së të ndryshuara në vitin 2017, duke mos shteruar kështu mjetet juridike efektive në dispozicion.

18. Në datën 31.5.2021, kërkuesi i ka kërkuar Gjykatës së Lartë gjykimin e çështjes me procedurë të përshpejtuar, me argumentin se ajo përfshihej në kategorinë e këtyre çështjeve, pasi ekzekutimi i saj ishte pezulluar dhe ai kishte mundësi të kufizuara ekonomike, si dhe rreth 5 vjet në pritje të shqyrtimit të saj. Në datën 3.11.2021 Gjykata e Lartë e ka informuar kërkuenin se çështjet shqyrtohen në bazë të një radhe gjykimi, në përputhje me periudhën e regjistrimit të dosjes në sekretarinë gjyqësore dhe se çështjet administrative me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të punës regjistrohen në kategorinë e çështjeve administrative, të tipit “Të tjera”. Po kështu, në datën 16.5.2022, po ajo gjykatë, e ka informuar se çështja administrative që i përket themelit të padisë dhe kërkesa e revokimit të vendimit të pezullimit do të shqyrtohen në datën 26.5.2022, datë në të cilën ajo ka disponuar përfundimisht me vendimin objekt të ankimit kushtetues.

19. Gjykata eidenton se me ndryshimet që i janë bërë KPC-së me ligjin nr. 38/2017, hyrë në fuqi më 5.11.2017, është përcaktuar, ndër të tjera, se cilat konsiderohen afate të arsyeshme (*neni 399/2*), cili konsiderohet shpërblim i drejtë (*neni 399/3*), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave (*nenet 399/4 dhe 399/6*), përfshirë rregullat për gjykimin e kërkesës (*neni 399/7*). Në këtë mënyrë, ligji procedural ka parashikuar mjete ligjore/instrumente efektive për t’i garantuar individit mbrojtjen e së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm, të cilat, sipas jurisprudencës së kësaj Gjykate, në parim, janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret (*shih vendimet nr. 10, datë 7.3.2023; nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se në datën 31.5.2021, kërkuesi i ka kërkuar zëvendëskryetarit të Gjykatës së Lartë gjykimin e çështjes së tij me procedurë të përshpejtuar. Gjykata vëren se ky mjet ligjor i përdorur prej tij nuk është ai i parashikuar në *nenet 399/1* e vijues të KPC-së, i cili garanton mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm përpara Gjykatës së Lartë. Në këtë situatë, sikurse me të drejtë ka parashtruar edhe subjekti i interesuar, DAP-i, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive që ka pasur në dispozicion për mbrojtjen e saj. Për rrjedhojë, ajo nuk mund të shqyrtojë as pretendimet që lidhen me cenimin e të drejtave me natyrë ekonomike të pretenduara, për shkak të vonesës së gjykimit nga Gjykata e Lartë.

21. Për sa u takon pretendimeve të tjera që lidhen me cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj, parimit të sigurisë juridike të lidhur me gjykimin e drejtë, si dhe së drejtës së mbrojtjes, Gjykata çmon se kërkuesi nuk ka më mjete të tjera ankimi ndaj vendimit të Gjykatës së Lartë që ka përmbyllur gjykimin në themel të padisë së tij, për rrjedhojë ai e ka plotësuar kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive.

22. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, bazuar në *nenin 71/a*, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastin konkret, Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 26.5.2022, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 12.10.2022, pra pas 4 muajve e 16 ditëve. Sipas akteve bashkëlidhur ankimit kushtetues të paraqitura nga vetë kërkuesi, rezulton se palët ndërgjyqëse kanë marrë dijeni për vendimin e kundërshtuar nëpërmjet njoftimit elektronik në adresat e kontaktit, përfshirë edhe atë të kërkuetit, në datën 13.6.2022. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ankimi kushtetues është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

23. Në drejtim të kriterit të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesi ka kundërshtuar veprimet administrative të ndërmarra nga institucionet e administratës publike për kalimin e tij në listëpritjeje, me pasojë cenimin e marrëdhënieve të punës dhe procesin gjyqësor të iniciuar prej tij për pavlefshmërinë e këtyre veprimeve. Sipas tij, Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, në drejtim të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, parimit të sigurisë juridike të lidhur me gjykimin e drejtë, si dhe së drejtës së mbrojtjes, të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës.

24. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me gjykimin e drejtë, pasi Gjykata e Lartë ka zbatuar gabim ligjin referuar efekteve të vendimit nr. 5/2014, të Gjykatës, në shkelje të nenit 76, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000. Sipas tij, vendimi i kundërshtuar rrëzon të gjitha pasojat e këtij vendimi, duke njohur si të vlefshme aktet administrative të dala nga një akt normativ i shpallur si i papajtueshëm me Kushtetutën. Po kështu, ai ka argumentuar se kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit, cenojnë parimet, standardet dhe të drejtat kushtetuese, atëherë interpretimi i ligjit i nënshtrohet kontrollit kushtetues.

25. Subjektet e interesuara, MBZHR-ja dhe DAP-i, kanë prapësuar se pretendimet janë të pabazuara, pasi Gjykata e Lartë ka zbatuar ligjin që ka qenë në fuqi në kohën e nxjerrjes së akteve të kundërshtuara, për të cilat janë respektuar procedurat ligjore. Zbatimi i këtij ligji është në referencë edhe të nenit 68, të ligjit nr. 152/2013, sipas të cilit procedurat e nisura sipas ligjit nr. 8549/1999, do të përfundojnë sipas dispozitave të këtij ligji. Kërkuesi ka paraqitur padi pas hyrjes në fuqi të vendimit të Gjykatës, për pasojë, ky i fundit, nuk mund të kishte efekte prapavepruese, sipas nenit 76, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000. Përderisa kërkuesi nuk ka paraqitur padi brenda afatit ligjor, pra deri në datën 26.2.2014, kur ligji nr. 8549/1999, ka prodhuar efekte, ai, me vetëdije, ka lejuar kalimin e afatit dhe humbjen e së drejtës. Në këtë situatë, kërkuesi duhet t'i adresonte gjykatës argumente për pavlefshmërinë e aktit administrativ të kalimit në listëpritjeje referuar ligjit që ka vepruar në atë kohë dhe jo ligjit të mëvonshëm. Përcaktimi i ligjit të zbatueshëm për zgjidhjen e çështjes përfshihet brenda kompetencave të Gjykatës së Lartë, si gjykata e ligjit.

26. Gjykata ka pohuar se parimi i sigurisë juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin (*shih vendimin nr. 11, datë 21.4.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa u përket të drejtave të fituara si element i parimit të sigurisë juridike, Gjykata është shprehur se çdo proces ku vihen në dyshim të drejtat e fituara, nuk mund të konsiderohet se qëndron jashtë nocionit të “procesit të rregullt”, përderisa diskutohet e vendoset lidhur me to. Ky parim është i detyrueshëm të respektohet në të gjitha fazat e një procesi ku pretendohet cenimi i të drejtave të fituara dhe siguria juridike që rrjedh prej tyre (*shih vendimet nr. 22, datë 29.9.2022; nr. 10, datë 13.2.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, ajo ka theksuar se mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre nuk përbën lëndë kushtetuese (*shih vendimet nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 6, datë 16.2.2021; nr. 9, datë 26.3.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesi ka kundërshtuar aktet administrative për kalimin e tij në listëpritjeje, mbështetur në ligjin nr. 8549/1999, ligjin nr. 152/2013 dhe vendimin nr. 5/2014, të kësaj Gjykate. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përfshirë edhe Gjykatën e Lartë, pasi kanë marrë në shqyrtim përmbajtjen dhe procedurën për nxjerrjen e akteve të kundërshtuara, si dhe i kanë analizuar ato në raport me dispozitat ligjore të zbatueshme, kanë konkluduar me zgjidhjen në themel të padisë së tij. Nga analiza e argumenteve nuk konstatohet që kërkuesi të ndodhet në kushtet e ndonjë të drejte të fituar nga ligji apo nga gjykata me vendim gjyqësor të formës së prerë, e cila të jetë vënë në dyshim nga vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë. Ndërkohë që çështja e pritshmërive nga zbatimi i normave ligjore, lidhet me interpretimin dhe zbatimin në kohë të tyre, që është atribut i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues. Nën dritën e kësaj analize, Gjykata vlerëson se pretendimet e

kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me gjykimin e drejtë nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues.

28. Ndërsa për sa u takon pretendimeve të tjera që lidhen me parimin e gjykatës së caktuar me ligj dhe së drejtës së mbrojtjes, Gjykata çmon se ato hyjnë në juridiksionin dhe kompetencën e saj, ndaj në vijim do të analizohet bazueshmëria e tyre në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj

29. Kërkuesi ka pretenduar se vendimi nr. 00-2022-1029 (210), datë 26.5.2022, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk është marrë nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi ky kolegji ka marrë një vendim të ndryshëm nga praktika e vendosur më herët prej tij. Konkretisht, ky kolegji në vendimin nr. 00-2014-730, datë 6.3.2014, i ka konsideruar të paligjshme vendimet që rregullonin marrëdhëniet e punës të nëpunësve civilë me ligjin e mëparshëm pas datës 1.10.2013. Për më tepër, nga ky ndryshim i njëanshëm i praktikës, i cili sjell efekte prapavepruese për vendimin e marrë nga gjykata e apelit, kërkuesit i vijnë pasoja të pafavorshme. Bazuar në dispozitat e KPC-së, ndryshimi i praktikës së mëparshme mund të bëhet vetëm nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

30. Subjekti i interesuar, MBZHR-ja, ka prapësuar se vendimi i referuar i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë ka si objekt të tij zgjidhjen e çështjes së juridiksionit, nëse ajo i përkiste atij administrativ ose civil dhe nuk është shprehur për zgjidhjen në themel të çështjes. Vendimi i referuar nuk është i detyrueshëm për gjykatat e nivelit më të ulët.

31. Subjekti i interesuar, DAP-i, ka prapësuar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në rastin në shqyrtim, nuk ndodhej në kushtet e nenit 62/a, të ligjit nr. 49/2012, për nisjen e procedurës për të njëzuar ose ndryshuar praktikën gjyqësore. Përfundimi i arritur prej tij për ligjin e zbatueshëm në raport me vendimarrjen e kësaj Gjykate për shfuqizimin e aktit normativ nr. 5/2013, përbën çështje të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, gjë e cila nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues.

32. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e tyre, ka të drejtën e një gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj. Ndërsa në nenin 141, pika 1, parashikohet se Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit.

33. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se shqyrtimi i çështjes nga një “*gjykatë e caktuar me ligj*” karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar për një procedurë ligjrisht të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t’i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 7, datë 23.2.2021; nr. 27, datë 24.6.2013; nr. 22, datë 22.7.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Po kështu, Gjykata ka pohuar se roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme dhe se ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për të kryer rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta. Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë e ligjit, ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 29, datë 1.11.2022; nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 6, datë 16.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata konstaton se kërkuesi i ka mbështetur argumentet e tij për pretendimin e cenimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, në faktin se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 00-2022-1029 (210), datë 26.5.2022, ka

rënë ndesh me qëndrimin e po këtij kolegj të shprehur në vendimin nr. 00-2014-730, datë 6.3.2014, ndryshim i cili mund të bëhej vetëm nga Kolegjet e Bashkuara të kësaj gjykate. Në vendimin nr. 00-2014-730, datë 6.3.2014, Kolegji Administrativ ka marrë në shqyrtim ankimin e veçantë lidhur me përcaktimin e juridiksionit – gjyqësor ose administrativ, të cilit i përkiste zgjidhja e mosmarrëveshjes objekt i atij gjykimi, mbështetur në kuadrin ligjor për nëpunësin civil, në ndryshim nga vendimi nr. 00-2022-1029 (210), datë 26.5.2022, që kërkuksi kundërshton në ankimin kushtetues individual.

36. Gjykata vëren se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. 00-2022-1029 (210), datë 26.5.2022, e ka mbështetur vlerësimin e tij në analizën dhe interpretimin e legjislacionit për statusin e nëpunësit civil të zbatueshëm në kontekstin e rrethanave të rastit konkret që i përkasin kërkuksit. Konkretisht, ai ka ushtruar kontroll në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimit të kundërshtuar në rekurs, pra në mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta në raport me veprimet e ndërmarra nga institucionet e administratës publike. Gjithashtu, nuk rezulton që vendimi i referuar nga kërkuksi të jetë njësuës për praktikën gjyqësore dhe vendimi i kundërshtuar në ankimin kushtetues individual të ketë ndryshuar praktikën gjyqësore, duke mos qenë kështu përpara rastit të përfshirjes së kësaj çështjeje në kompetencën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Nën këtë optikë, Gjykata çmon se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në rastin konkret, nuk ka tejkaluar kompetencat e tij ligjore.

37. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuksit për cenimin e parimit për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj është i pabazuar.

B.2. Për cenimin e së drejtës së mbrojtjes

38. Kërkuksi ka pretenduar se ai nuk është njoftuar lidhur me vendimin e revokimit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, gjë e cila ka sjellë mohimin e mundësisë për t'u njohur me arsyet e këtij vendimi dhe me paraqitjen e parashtimeve shtesë përpara zhvillimit të seancës në dhomën e këshillimit. Po kështu, duke qenë se njoftimi për shqyrtimin e çështjes është bërë 9 ditë përpara zhvillimit të seancës, atij nuk i është dhënë mundësia për të paraqitur parashtimet me shkrim sipas rregullave të gjykimit në dhomën e këshillimit, ku parashikohet se palët duhet të kenë të paktën 15 ditë kohë që të paraqesin pretendimet e tyre.

39. Subjekti i interesuar, MBZHR-ja, ka prapësuar se kërkuksi nuk ka paraqitur argumente kushtetuese, por vetëm ka sqaruar kronologjinë e situatës. Gjykata e Lartë, me shpresën e datës 16.5.2021, e ka bërë me dije kërkuksin për datën e zhvillimit të seancës gjyqësore, por ai nuk ka paraqitur parashtime me shkrim edhe pas kësaj date.

40. Subjekti i interesuar, DAP-i, ka prapësuar se pretendimi i kërkuksit, në thelb, lidhet me të drejtën e aksesit, për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, i cili rezulton të jetë i pabazuar. Njoftimi me shpallje është publikuar në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë në datën 10.5.2022, pra 15 ditë përpara datës 26.5.2022 kur është zhvilluar gjykimi. Kërkuksit i është krijuar mundësia për të paraqitur argumentet e tij me shkrim, pasi ka paraqitur kundërrekurs. Ai nuk ka provuar se vendimi i kundërshtuar do të ishte i ndryshëm nëse ai do të kishte marrë dijeni 15 ditë përpara zhvillimit të seancës. Po kështu, nuk rezulton që ai t'i jetë drejtuar me kërkesë Gjykatës së Lartë për shtyrjen e seancës, me qëllim respektimin e afatit të njoftimit.

41. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën, në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 37, datë*

30.6.2016; nr. 21, datë 4.4.2016; nr. 31, datë 26.5.2014, të Gjykatës Kushtetuese). Po kështu, gjatë shqyrtimit të pretendimeve për të drejtën për proces të rregullt ligjor nuk mjafton vetëm konstatimi i shkeljes procedurale, por duhet të analizohet karakteri i saj, pasojat që kanë ardhur për kërkuesin dhe për interesat që ai përfaqëson (shih vendimin nr. 38, datë 2.12.2021, të Gjykatës Kushtetuese). Në çdo çështje të veçantë, duke pasur parasysh edhe të gjithë procedurën që mund të jetë ndjekur, Gjykata vlerëson nëse një kufizim ose shkelje gjatë kësaj procedure ka ndikuar drejtpërdrejt në zgjidhjen e çështjes dhe ia ka bërë palës të pamundur mbrojtjen dhe zhvillimin e procesit gjyqësor në mënyrë të drejtë (shih vendimin nr. 7, datë 28.2.2000, të Gjykatës Kushtetuese). Ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (shih vendimet nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 71, datë 13.11.2017, të Gjykatës Kushtetuese).

42. Gjykata vëren se kërkesat kushtetuese të procesit të rregullt ligjor janë reflektuar në përmbajtjen e nenit 61 të ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë të dokumenteve në dhomën e këshillimit (pika 1). Gjyqtari relator cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, duke urdhëruar njoftimin e palëve. Sekretaria e gjykatës njofton, me shpallje, ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues, të paktën 15 ditë përpara (pika 2). Në shtesë të këtyre rregullave, neni 482, pika 3, i KPC-së, i zbatueshëm për gjykimin administrativ, parashikon se njoftimi me shpallje bëhet edhe në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë.

43. Duke iu rikthyer rastit konkret, Gjykata vëren se subjektet e interesuara, MBZHR-ja dhe DAP-i, kanë ushtruar rekurs ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit. Kundër shkaqeve dhe pretendimeve të tyre, kërkuesi ka paraqitur dy kundërrekrurse, si ndaj pretendimeve të MBZHR-së ashtu edhe ndaj atyre të DAP-it. Fillimisht, në datën 13.2.2018, Gjykata e Lartë ka vendosur shqyrtimin e rekrurseve në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Më tej, në datën 9.5.2022, pas ndryshimeve të ligjit nr. 49/2012, me ligjin nr. 49/2021 dhe të KPC-së me ligjin nr. 44/2021, ajo ka vendosur revokimin e këtij vendimi dhe shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi mbi bazë të dokumenteve në datën 26.5.2022. Në vendimin e revokimit, trupi gjykues i ka lënë detyrë sekretarisë të bëjë njoftimin e palëve me qëllim paraqitjen nga ato të parashtresave. Njoftimi për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi palëve iu është përcjellë me shkresën nr. 00714/16 akti, datë 11.5.2022. Për kërkuesin, njoftimi me shkresë rezulton i kthyer nga shërbimi postar me shënimin “Objekt i pakërkuar”. Nga ana tjetër, me shkresën nr. 1820/1 prot., datë 16.5.2022, në përgjigje të interesimit të kërkuesit, Gjykata e Lartë e ka informuar atë për shqyrtimin e çështjes në datën 26.5.2022. Ndërkohë, në përmbajtjen e vendimit nr. 00-2022-1029 (210), datë 26.5.2022, Gjykata e Lartë ka shënuar se: “pas njoftimit të vendimit të revokimit të kalimit të çështjes në seancë gjyqësore, palët rezultojnë të kenë marrë dijeni rregullisht dhe nuk kanë paraqitur parashtime me shkrim” (shih paragrafin 27, të vendimit të Gjykatës së Lartë).

44. Po kështu, nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore dhe konkretisht nga përmbajtja e procesverbalit të shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit, që mban datën 26.5.2022, rezulton e shënuar se palët ndërgjyqëse kanë marrë dijeni rregullisht sipas ligjit, nëpërmjet shpalljes së datës 10.5.2022 dhe nuk kanë paraqitur ndonjë kërkesë procedurale për përjashtimin e trupit gjykues. Nga verifikimi i kryer në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë rezulton se në datën 10.5.2022 është njoftuar lista e çështjeve administrative për shqyrtim në dhomën e këshillimit, në të cilën është pasqyruar edhe përbërja e trupit gjykues, relatori dhe ora e gjyqimit të çështjes së kërkuesit. Njoftimi është shpallur edhe në ambientet fizike të asaj gjykate. Ndërkohë, si edhe më lart u parashtrua, me shkresën e datës 16.5.2022, Gjykata e Lartë e ka informuar kërkuesin se çështja e tij së bashku me kërkesën për revokimin e vendimit të pezullimit do të shqyrtohej në datën 26.5.2022.

45. Për sa më sipër, Gjykata eidenton se më herët ka qenë vetë kërkuesi, i cili, nëpërmjet avokatit të tij, i ka kërkuar Gjykatës së Lartë revokimin e vendimit për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore dhe shqyrtimin e saj në dhomën e këshillimit. Po kështu, nuk rezulton që kërkuesi,

edhe pas marrjes dijeni të datës së shqyrtimit të çështjes së tij në dhomën e këshillimit, të ketë paraqitur parashtrime shtesë, të ketë kërkuar kohë shtesë ose shtyrjen e datës së shqyrtimit të çështjes, me qëllim paraqitjen e parashtrimeve shtesë.

46. Gjykata çmon se kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë argument konkret në lidhje me pamundësinë e përdorimit të garancive procedurale që do t'i siguronin mbrojtjen efektive, në kushtet e një afati jo të plotë njoftimi referuar njoftimit me shkresë të tij. Ai nuk ka argumentuar se si vendimi i ndërmjetëm për ndryshimin e formës së gjykimit, i cili nuk i është njoftuar për shkak të kthimit nga shërbimi postar, të ketë ndikuar në të drejtat procedurale të tij. Për më tepër, Gjykata vëren se kërkuesi nuk ka bërë asnjë përpjekje për të kërkuar kohë shtesë ose shtyrjen e datës së gjykimit, me qëllim paraqitjen e parashtrimeve shtesë të tij. Në këto rrethana, mosrealizimi i njoftimit të vendimit të ndërmjetëm nuk e ka vendosur kërkuenin në pozita të pafavorshme lidhur me të drejtën e mbrojtjes efektive ose me gjykimin e çështjes në tërësi.

47. Nga ana tjetër, lidhur me themelin e çështjes, Gjykata vlerëson se kërkuesi është njoftuar rregullisht për rekursin e paraqitura nga palët ndërgjyqëse, për të cilat ka paraqitur kundërshtimet e tij me shkrim, duke iu garantuar në këtë mënyrë e drejta për t'u dëgjuar dhe për të paraqitur argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare. Po kështu, njoftimet për datën dhe orën e shqyrtimit të procesit të tij janë afishuar rregullisht nga Gjykata e Lartë. Në ankimin kushtetues, ai nuk ka paraqitur ndonjë pretendim konkret për kufizimin e aksesit nga afati jo i plotë i njoftimit, në njoftimet e shpallura të Gjykatës së Lartë dhe as ndonjë argument thelbësor të ri të paparashtruar më parë, i cili potencialisht mund të passillte një rezultat të ndryshëm të zgjidhjes së çështjes së tij nga Gjykata e Lartë. Për më tepër, kjo e fundit ka shqyrtuar në themel shkaqet e rekursit, që do të thotë se ka analizuar dhe vlerësuar pozitën dhe të drejtat e kërkuetit në raport me vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta. Ndërkohë që gabimet në dukje, në përmbajtjen e vendimit të kundërshtuar, në kontekst të rastit konkret, nuk janë të tilla që ta bëjnë të parregullt, në kuptimin kushtetues, procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuetit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes efektive është i pabazuar.

48. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuetit, sipas arsytimit të mësipërm, janë të pabazuara, ndaj kërkesa duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 26.5.2023.

Shpallur më 26.6.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Sandër Beci, Marjana Semini, Genti Ibrahim